



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **13 shkurt 2026, (e premte)**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **Fatmir Iska**.

Kryesuesi: Fillimisht, besoj që materialin e keni pranuar! Atëherë, përshëndetje për të gjithë! I nderuari nënkryetar i Komunës, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, kabinetin e kryetarit, kabinetin tim, si dhe asistenten e kryesuesit!

E hapim mbledhjen e **parë (1)** për këtë vit kalendarik. Në konsultim me Kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “KRM Ekoregjioni” në Rahovec;
2. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Rahovec;
3. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit *ad hoc* për shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve që kanë konkurruar për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe;
4. Shqyrtimi i Projekt-rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistemimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Rahovecit;
5. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr. prot. 01 Nr. 181/24, të datës 30.1.2024, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr. 20/25, i datës 28.2.2025, për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit;
6. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP);
7. Shqyrtimi i vendimit për miratim të Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026;
8. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-05058-0 ZK-Rahovec;
9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm të pjesë së parcelës P-71510057-02240-80 ZK-Rahovec;
10. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-08152-0 ZK-Rahovec;
11. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025;
12. Shqyrtimi i informatës së KKS-së për vitin 2025;
13. Shqyrtimi i kërkesës së Kompanisë Regjionale për Mbeturina “Ekoregjioni”, për ngritjen e tarifës së shërbimit të mbeturinave;

14. Të ndryshme.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, ky është rendi i ditës për sot. A ka dikush diçka rreth rendit të ditës? Paraprakisht, ju njoftoj që te pika e fundit te të ndryshme, do t'ju njoftoj pikë disa pika shtesë.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, kryesues! Për planin e punës së kuvendit e kemi mbajtur një punëtori, nga e cila janë nxjerrë disa plotësim-ndryshime. A janë bërë këto ndryshime tani, apo për seancë?

Kryesuesi: Plani i punës është ndryshuar dhe për seancën e rregullt do ta keni gati.

1. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “KRM Ekoregjioni” në Rahovec:

Përparim Krasniqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, anëtarë të KPF-së. Zakonisht ky vendim duhet prezantuar nga kabineti i kryetarit, mirëpo, për shkak që si drejtori e Shërbimeve Publike na takon edhe neve. Ky vendim është i përcaktuar sipas ligjit të ndërmarrjeve publike dhe i obligon komunat që t'i formojnë komisionet e aksionarëve për ndërmarrjet publike. Nga zyra ligjore kërkoj që të shtohet një paragraf, ku thuhet që raportimi duhet të jetë një herë në vit.

2. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i autobusëve” në Rahovec:

Skender Hamza: Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të KPF-së! E informoj drejtorin që në pikën e pestë është precizimi ku komisioni duhet të raportojë një herë në vit.

Përparim Krasniqi: Faleminderit, Skend! Për shkak se është ndërmarrje publike komunale, për dallim nga komisioni të “KRM Ekoregjioni” ku e kemi një anëtar, këtu duhet t'i kemi 4 anëtarë sepse komuna është 100% pronare, ndërsa në Prizren jemi me 8% si aksionarë.

Defrim Kafexhiu: I nderuar kryesues, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të KPF-së! Drejtor, te puna e raportimit, sipas vendimit ka qenë edhe në mandatin e kaluar. Në këtë rast, anëtarët e Kuvendit nuk kanë qenë të informuar për gjendjen financiare të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i autobusëve”. Aty, dihet që është një ndërmarrje që vazhdimisht ka investime nga komuna dhe qytetarët, përmes nesh, kanë nevojë të jenë të informuar rreth gjendjes financiare të kësaj ndërmarrjeje. Sivjet, a do të ketë ndonjë raport për vitin e kaluar?

Përparim Krasniqi: Raportimet janë të rregullta dhe janë publike. Në vitin e parë e kemi pasur një raportim, ndërsa në dy vitet e fundit nuk kemi raportuar, sepse raportet janë bërë publike. Sidoqoftë, nuk e vërejtja që është e precizuar që një herë në vit duhet të raportojmë për gjendjen financiare.

Kryesuesi: A ka dikush diçka rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet pika e dytë.

3. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit *ad hoc* për shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve që kanë konkurruar për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe:

Skender Hamza: Koordinator i këshillin e Fshatit mungon dhe unë do ta prezantoj sipas informatave që kam. Konkursin e kemi hapur dhe ka afat deri më 18. Pas kalimit të afatit të konkursit, komisioni i merr të gjitha aplikimet dhe i përzgjedh 5 emrat që duhet të aprovohen nga ana juaj në Kuvend.

Defrim Kafexhiu: Në mandatin e kaluar, nga përvoja që e kemi pasur, komisioni i themeluar nga Kuvendi nuk ka arritur ta kryejë ashtu siç duhet punën e tyre. Ata vetëm i kanë deleguar punët në Kuvend, kur në fakt është dashur që ata t'i përzgjedhin kandidatët. Nëse ju kujtohet, në kuvend kanë ardhur emra më shumë se që duhet dhe këtu janë votuar një nga një ata që kanë aplikuar. Kryesues, të ftoj që t'i qëndrosh gati komisionit, që ta kryej punën dhe t'i përzgjedh anëtarët, tutje të vijnë si pako në kuvend për miratim dhe jo në kuvendarët ta luajmë rolin e komisionit në përzgjedhje.

Skender Hamza: Po, Defrimi e tha saktë. Komisioni i përzgjedh anëtarët që aplikojnë të komunitetit shqiptar, ndërsa, sa i përket komunitetit serb, e kemi mbajtur një takim me këshillin lokal të fshatit Hoçë e Madhe dhe kanë

kërkuar që ata të merren me aplikimet e tyre dhe t'i dorëzojnë dy emra te komisioni. Komisioni i përzgjedh dy emra të komunitetit shqiptar dhe bashkë me dy emrat e komunitetit serb që vinë nga këshilli lokal i Hoçës së Madhe, dorëzohen për në kuvend për t'u votuar si pako.

Lirigzon Kastrati: Puna e këtij komisioni, nuk është vetëm që t'i selektojë dy emra për në kuvend dhe nuk qëndron ajo që ne duhet t'i votojmë si paku. Votimi në kuvend do të jetë veç për dy anëtarë që na takojnë si kuvend, por kriteret dhe vlerësimin e tyre e vendosë komisioni. Ka kandidatë që i plotëson të gjitha kriteret dhe nuk mundesh që në komision t'i selektosh ashtu. Duhet të vendosen në kuvend: Këta janë kandidatët që i plotësojnë kriteret dhe pastaj mbetet në përgjegjësinë e anëtarëve të kuvendit.

Defrim Kafexhiu: Cili është roli i komisionit atëherë? Mirë do të ishte që të mos e formonim fare dhe të gjitha aplikimet të vijnë në kuvend. Në udhëzim administrativ përcaktohet: "Komisioni për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe" dhe ne këtu e votojmë një vendim të atij komisioni.

Skender Hamza: Udhëzimi administrativ, neni 1.4: Komisioni të dërgojë listën e përzgjedhur për aprovim në Kuvendin Komunal.

Kryesuesi: Besoj që kjo gjë do të sqarohet edhe në seancën e Kuvendit, duke u respektuar ligji, udhëzimi administrativ dhe rregullorja. Unë e di që konkursi është i hapur deri më datë 18 dhe pastaj mblidhet komisioni për shqyrtimin e aplikimeve. Se si do të trajtohen anëtarët e këshillit, a do të jenë bars me një asambleist edhe me pagë e trajtim, do të bazohemi në përpikëri në ligj dhe në udhëzim administrativ. Atëherë, kush është "për" këtë pikë të rendit të ditës? Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet pika e tretë.

4. Shqyrtimi i Projekt-rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistemimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Rahovecit:

Agron Thaqi: Përsëritet për të gjithë! Në kuadër të reformës për forcimin e administratës publike dhe rritjen e efikasitetit në punë, Komuna e Rahovecit ka marrë përsipër që ta bëjë draft-rregulloren për organizimin e brendshëm. Me vendim të kryetarit të komunës është formuar komisioni, i cili ka punuar në hartimin e draft-rregullore, e cila ka kaluar edhe në dëgjim publik dhe tani e presim që të kalojë edhe në faza të tjera, si dhe tutje të dërgohet në MAPL. Kjo rregullore do ta bëjë përcaktimin e qartë të strukturës organizative, si dhe ndarjen e përgjegjësisë ashtu siç parashihet me ligjet në fuqi.

Lirigzon Kastrati: I nderuar, te tabela për klasifikimin e vendeve të punës janë të rehat apo aktualet?

Agron Thaqi: Janë të rehat.

Lirigzon Kastrati: Sektorin për Buxhet dhe Financa, a do ta ndani në dy sektorë, për buxhet dhe për financa?

Agron Thaqi: Në dëgjim publik është propozuar ndarja në dy sektorë, për financa dhe për buxhet, si dhe sektori i tatimit në pronë, të gjitha në kuadër të Drejtorisë për Financa.

Kryesuesi: Unë kam diçka shkurt, këtu te secila drejtori shkruan "misioni", besoj që duhet të ndërrohet ky term dhe të bëhet "detyrë" apo "obligim". Po e vendosim në votim pikën. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht aprovohet edhe pika e katërt.

5. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr. prot. 01 Nr. 181/24, të datës 30.1.2024, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr. 20/25, i datës 28.2.2025, për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit:

Kryesuesi: Është përfaqësues pikë e njëjtë me pikën për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe, pra do të bëhet përzgjedhja e një anëtari nga komisioni i caktuar.

Lirigzon Kastrati: Mandati i këtyre anëtarëve të Komitetit, a përfundon me përfundimin e mandatit? Atëherë, jo, kemi vetëm zëvendësim.

Kryesuesi: Atëherë, po e vendosim në votim pikën. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet edhe pika e pestë.

6. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP):

Muhamet Morina: Përshëndetje! Për anëtarë të komisionit kemi përcaktuar një zyrtar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, Lulëzim Krasniqi (kryesues) dhe anëtare është Shemsije Shala – drejtoreshë e ShFMU “Heronjtë e Zatriqit” në Zatriq. Disa fjalë për kompetencat e këtij komisioni: Përzgjedhja prej dy anëtarëve është kompetencë e jona, të njëjtit i plotësojnë kushtet që të bëjnë vlerësimin e drejtorëve ose të kandidatëve që do të aplikojnë për drejtorë të këtyre shkollave. Komisioni ka për detyrë që t’i intervistojë kandidatët që kanë konkurruar në konkurset e cekura në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe në bazë të pikëve të fituara bëhet renditja e kandidatëve. Lista e kandidatëve që kanë më shumë pikë përcillet te kryetari, i cili bën emërimin e tyre si drejtorë. Komisioni është i obliguar që punët t’i kryejë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Mandati i komisionit përzgjedhës është 1 vjet. Pas miratimit nga Kuvendi, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 9 të ligjit 08/L-284 për shqyrtim administrativ të akteve të komunës dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e komunës.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Po e hapim debatin rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht kalon edhe pika e gjashtë.

7. Shqyrtimi i vendimit për miratim të Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026:

Kryesuesi: Më datë 10 e kemi mbajtur një punëtori dhe i kemi dhënë orientimet dhe sugjerimet tona, si dhe besoj që materialin do ta keni të gatshëm nga Sekretaria e Kuvendit. Ky plan nuk do të thotë që është përfundimtar, mund të ndryshohet përmes diskutimeve edhe në seancën e rregullt të Kuvendit. Nëse nuk ka dikush të shtojë diçka, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht kalon edhe pika e shtatë.

8. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-05058-0, ZK-Rahovec:

Besmire Bytyqi: Faleminderit, kryesues! I nderuari nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të KPF-së! Para jush e keni propozim-vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. I njëjti komision është formuar edhe në mandatin e kaluar, por tani duhet ta ndërrojmë, meqenëse tani kemi ndryshime në legjislativin dhe ekzekutivin e komunës.

Defrim Kafexhiu: Nëse ka mundësi të tregoni se ku gjendet parcela?

Besmire Bytyqi: Parcela gjendet te rruga transite në zonën kadastrale në Rahovec. Në emailin tuaj e keni pranuar edhe certifikatën e pronës, si dhe ortofoton e parcelës.

Lirigzon Kastrati: Komisionet jemi duke i ndryshuar, por vendimet jo. A kanë ligjshmëri këto?

Kryesuesi: E kam një kërkesë, që në seancën e rregullt të Kuvendit, për të gjitha pikat e rendit të ditës, të paraqiten me ortofoto në projektor këtu dhe të jemi orientimisht më të saktë për gjendjen e pronave që jepen në shfrytëzim. Po e vendosim në votim pikën e rendit të ditës. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet edhe pika e tetë.

9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm të pjesë së parcelës P-71510057-02240-80, ZK-Rahovec:

Besmire Bytyqi: Para jush e keni propozim-vendimin për një pjesë të parcelës 02240-80, ZK-Rahovec dhe pikërisht bëhet fjalë për parcelën te “Maja e Shkodranit”. Po kërkojmë që ta shpallim në interes të përgjithshëm pjesën prej 148m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 751 ha e 24 ari. Qëllimi: hapja e rrugës publike.

Defrim Kafexhiu: Drejtoreshë, ku do të hapet kjo rrugë më saktësisht?

Besmire Bytyqi: Bëhet fjalë për një parcelë të “Maja e Shkodranit”. Në email po ashtu e keni me ortofoto, të dërguar nga Zyra e Kuvendit Komunal. Kjo parcelë ka kaluar në ankand dhe tani po kërkojmë që t’i bëjmë qasje në rrugë, në mënyrë që ai të pajiset me lejet e nevojshme nga Drejtoria e Urbanizmit.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtoreshë! Po e vendosim pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, unanimitisht miratohet edhe pika e nëntë.

10. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-08152-0, ZK-Rahovec;

Besmire Bytyqi: Njëjtë sikurse në pikën e tetë të rendit të ditës, edhe këtu po kërkojmë ta formojmë komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vjet. Komisioni ka qenë funksional, mirëpo tani duhet ta ndërrojmë, sepse kemi ndryshime në legjislativin dhe ekzekutivin e komunës. Parcela gjendet në rrugën transite në zonën kadastrale në Rahovec.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtoreshë! Po e vendosim pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, unanimitisht miratohet edhe pika e dhjetë.

11. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025:

Skender Hamza: Për periudhën janar-dhjetor, Kuvendi i Komunës së Rahovecit i ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta, 1 mbledhje solemne, 1 urgjente dhe 1 inauguruese. KPF-ja - 10 mbledhje, Komiteti për Komunitete - 5 mbledhje. Të themeluar e kemi edhe Komitetin për Arsim, i cili ka mbajtur 1 mbledhje, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - 4 mbledhje, Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuara - 4 mbledhje, KKSB-ja 5 mbledhje. Kuvendi i Komunës, në mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2025, i ka miratuar gjithsej 50 vendime, 2 plotësim-ndryshime të rregullores, 17 raporte dhe 14 informata. Në raport i keni të cekura në formë tabelore të gjitha statistikat për zhvillimin dhe ecuritë e punimeve të Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve.

Kryesuesi: Faleminderit, Skender! Nëse nuk ka dikush diçka, po e vendosim pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, unanimitisht miratohet edhe pika e njëmbëdhjetë.

12. Shqyrtimi i informatës së KKSB-së për vitin 2025:

Skender Hamza: Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, KKSB-ja i ka mbajtur gjithsej 5 takime. Për dallim nga vitet e kaluara, kësaj radhe, 2 prej takimeve janë mbajtur jashtë kësaj salle. Një takim në Krushë të Madhe dhe një në Ratkoc. Në raport i keni të cekura të gjitha pika e rendit të ditës, si dhe konkluzat që janë marrë brenda këtyre takimeve.

Kryesuesi: Faleminderit, Skender! Nëse nuk ka dikush diçka, po e vendosim pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, unanimitisht miratohet edhe pika e dymbëdhjetë.

13. Shqyrtimi i kërkesës së Kompanisë Regjionale për Mbeturina “Ekoregjioni”, për ngritjen e tarifës së shërbimit të mbeturinave:

Përparim Krasniqi: E kemi një kërkesë nga kryeshefi ekzekutiv i KRM “Ekoregjioni” në Prizren, i cili i është drejtuar Kuvendit Komunal, Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për rritjen e tarifës për menaxhimin e mbeturinave. Në kërkesë thuhet: Sugjerimi ynë është që nga 5.5 të bëhet në 6. Kryeshefi ka harruar që ne në vitin 2023 e kemi bërë ndryshimin e rregullores dhe jemi komuna e parë që e kemi rritur tarifën në 6€ për amvisëri. Komuna e Prizrenit, Dragashit dhe Suharekës ende e kanë 4.5 tarifën për mbeturina. Sidoqoftë, mbetet te ju ta aprovoni, apo ta refuzoni këtë kërkesë.

Kryesuesi: Faleminderit! Këtu e kemi vetëm një kërkesë, e cila do të vendoset në Kuvend dhe tutje janë kuvendarët që do të marrin vendim. Gjithashtu, edhe unë do ta jap mendimin tim në seancën e Kuvendit.

Lirigzon Kastrati: Ashtu siç e tha drejtori, ne e kemi pasur një ndryshim të tarifës dhe në emër të grupit nuk mund ta pranojmë një kërkesë të tillë. Arsyeshmërinë e plotë do ta japim në seancën e Kuvendit.

Defrim Kafexhiu: Si i kanë marrë vendimet këto 5 komunat e tjera që janë aksionare, ku janë bërë kërkesat e njëjta nga kryeshefi ekzekutiv? Këtu thuhet që me një vendim që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2023 (vendimi i

Ministrisë së Ekonomisë) në bazë të cilit automatikisht rritet tarifa e mbeturinave nga 5.81€ për 1 ton, në 10.81€ për 1 ton për vitin 2026. Këtë vendim nuk kam mundur ta gjej. Besoj që për seancën e rregullt duhet të kemi edhe material shtesë. Mendimi im është që duhet të presim se si po ia bëjnë kuvendet e komunave të tjera dhe tani ta marrim një vendim. Në parim jam kundër, sepse këtu po dyfishohet çmimi që Ekoregjioni do të paguajë në deponi, ndërsa kërkesa është më e arsyeshme kundrejt çmimit për amvisëri. A është real ky dyfishim i tarifës në deponi në Landovicë?

Përparim Krasniqi: Defrim, unë e sqarova. Komunat e tjera janë larg Rahovecit me tarifa. Ajo që the për tarifën prej 5.81 në 10.81 në Landovicë, ekziston edhe një vendim tjetër që çdo vit rritet çmimi për 1€. Në krahasim me komunat e tjera jemi në përparësi, për shkak që e kemi respektuar një rregullore dhe e kemi rritur tarifën, tani e kemi 6€. Sidoqoftë, duhet ta diskutojmë edhe në Kuvend.


Kryesuesi: Atëherë, po e kalojmë për shqyrtim këtë kërkesë dhe në seancën e Kuvendit do të merret vendimi.

14. Të ndryshme:

Kryesuesi: Më lejoni t'ju informoj që me gjasë në seancën e rregull të Kuvendit do t'i kemi edhe 3 pika shtesë:

1. Plotësim-ndryshimi i vendimit për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete;
2. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e lokacionit për banim social;
3. Vendim për caktimin e 3 anëtarëve nga Kuvendi Komunal për këshillin e përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës, ku 2 anëtarë do t'i ketë AAK-ja dhe 1 LDK-ja. Në fund, e lus edhe drejtorin e Administratës, meqenëse është kuvendi i ri, t'i fillojë procedurat për blerjen e laptopëve për anëtarët e Kuvendit. Ju falënderoj për angazhimin tuaj dhe shihemi në seancën e rregullt të kuvendit!

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi


KRYESUESI

Fatmir Iska